



Rubairat e Omer Hajamit

1

Natën kur flinja, më tha shpirti: “Pi!
Në gjumë dhe në Varr s’ka lumëri;
Ngreh-u! Sa rron, zbras Kupa dhe puth Çupa;
Ke shekuj që të flesh në qetësi.”

2

Në ëndërr, kur Agimi zbardhëllonte,
Një zë që nga Taverna po gjëmonte:
“Çohuni djem, e Verë sillnani,
Se Fati na e theu lëngun sonte.”

3

Dhe posa në Tavernën këndoj gjeli,
Besnikët jashtë thirrë: “Portat çel-i!
E shkurtër është Jeta, ja, u-mplakmë
Dhe mbetmë si kofini pas të vjeli.”

4

A di përse këndesi po këndon
Me-natë dhe nga gjumi po të zgjon?
Që shkoj një ditë po të lajmëron,
Dhe ti, çkujdesur, fle dhe ëndërron.

5

U-gdhi! Me Verë zëmrën e zbardhëllonj
Për-dhe çdo Fe të Natës e dërrmonj:
Në Djall dërgonj Parajsën përpjetë,
Gërshetin me Llaut’ e lavdëronj.

6

Kur Diellin, me zjarr kurorëzuar,
E pret me gas Natyra faqe-shkruar,
Shoqen me mall po shoh në gjumë shtruar
Dhe foshnjën buzë-qeshur më të zgjuar.

7

Ja, Kup’ e Qiellit skuqet prej Agimit,
Bilbili nisi këngën e dëfrimit
Me Trëndafilin: Eja, Faqe-pjeshkë,

Natyra qesh; nem Qelqin e Rubinit.

8

Zgjoh-u! Mëngjesi me shigjet' e grisi
Perden e Natës, Yjt' i arratisi,
Dhe Dielli gjahtar me reze kapi
Çdo majë malli e pallati e lisi.

9

O Ëngjëll faqe-dritë, ja u-gdhi,
Shtirë Verë dhe këndo me ëmbëlsi
Xhamshidi e Khosroj qysh lulëzuan,
Qysh dimërojnë sot në Varr-verri.

10

Ja, Mars' i ri dëshirat na valon,
Çdo shpirt i mënçur në Gërmadhën shkon
Ku dor' e Moisiut zbardh nga degët
Dhe frym' e Krishtit tokën gjelbëron.

11

Mi lulen po pikojnë vesë retë,
Dhe me një zë qjellor Bilbil' i shkretë:
Ah, Verë! Verë! Verë! Trëndafilin
I lyp të skuqe faqezën e zbetë.

12

Bilbili nëpër kopshtet në Pranverë
Sheh Lilin Ku[' e Trëndafilin Verë
Dhe thotë: "Puthni e pihuni!
S'e gjeni këtë ditë tjetër herë."

13

Shiko luadhe, lule, bukuri,
Lumënj kristali, kronj e brohori:
Nga dimri Ferr pranvera Qjell na ndriti,
Gëzo mi Dhe Parajsen me Huri

14

Qesh Trëndafilin e thotë: "Lulëzonj

Dhe botës bukurinë po ia shtonj:
Pastaj e hap kuletën e mëndafshtë
Dhe përmi kopsht thesarin po e shtronj.”

15

“Jam thotë, lulja e Josefit ri
T’Egjiptës, xhevahir, zëmër-flori:
Ja edhe rrob’ e kuqe gjak, e çjerur
Prej vllazërve dhe gruas Petefri

16

Tufani kopshtin kur m’a çkatërron
Dhe Rrot’ e Fatit shpresat m’i dërmon,
Pështillem si burbuq’ i Trëndafilin,
Po zëmra gjak përbrënda më pikon.

17

U-dogja dhe u-përvëllova: Verë!
Nga vrer’ o loteve u-shova: Verë!
Një Qelq rubin, e Dashur, dhe Llautën
Dhe nga ky zjarr shpëtova: Verë!

18

Me Ver’ e Vajza, me Llaut e Valle,
Me Fyell e me Këngë po s’u-çmalle,
Jeta s’vlen hiç: Se pa këto nuk është
Veç pemë helmi, pus e tym vërdallë.

19

Nga njëra dorë Trëndafil e Grua,
Nga dora tjetër patsha Rrush e kua:
“Zotit – po thon’ – i arthtë keq për mua!”
Po as m’a fa; pendimin as ia dua.